

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: J u erdhi fundi!
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/dita-e-119-te-e-protestes-qytetaret-zbresin-serish-ne-shesh-kerkohe-i516216
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 17:01:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 16:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3849c6c76382f7a5f77f3fcb04df8f59ecdc670887c9e403fe3a71f0c7a31973
TEKSTI	0c16050cab8af2bf410a0a80b135847e73fa1205e8712db6b806c9dddb514214
PAMJA	a45efc5055b3940242ab1ae54eb9023e41f37e59df21a62f75fa45fec38c2cf3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9fb11e2b05dc94d86a333dfbe2c77f60c6e171236c9b30f06526567c2355008b
E MËPARSHMJA	31f86605a06a681d42ae3cf7a265af03e053c90947ad4081ad141705d102e892
RRËNJA MERKLE	20cb9bc098b6b22129b01f41a10ad3ad7e12cceb89fa0b5f21647847572e06c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/9fb11e2b05dc94d86a333dfbe2c77f60c6e171236c9b30f06526567c2355008b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

29 MINUTA ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më guajtur me vezë

2 ORE ME PARE

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

6 ORE ME PARE

Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar

7 ORE ME PARE

Shpërthimi i fuqishëm në lagjen Plaka në Greqi/ Humbin jetën 6 persona, mes tyre dhe 3 shqiptarë të pajetë në rrënoja (EMRAT+PAMJET)

LIVE UPDATES

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

• Qytetarët u mbledhën sot në ditën e 119-të të revoltës së tyre. • Ata u organizuan fillimisht në sheshin "Skënderbej" dhe më pas vijuan marshimin drejt Kryeministrisë, ku dhe zhvilluan fjalimet e tyre. • Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ku artikuluan kërkesat e tyre dhe bënë thirrje për ndryshim. • Aktivistja Sidorela Vatnikaj akuzoi qeverinë se është e lidhur me oligarkë dhe persona të përfshirë në çështje korrupsioni e krimi të organizuar, duke përmendur arrestimin e Ergys Agasit. • Sipas Vatnikaj, këto zhvillime tregojnë se shteti ka rënë dhe se kryeministri Edi Rama është i delegjetimuar. • Ajo kërkoi që Rama të thirret nga drejtësia, të merret në pyetje dhe të hetohet për lidhje të dyshuara me krimin e organizuar, ndërsa e mbylli deklaratën duke thënë se protesta zhvillohet për arrestimin e Ramës. • Aktivisti Erald Noj ishte një nga folësit në protestën e ditës së sotme. • Gjatë fjalës së tij në podiumin e vendosur para godinës qeveritare, ai i konsideroi protestuesit si heronj, ndërsa vlerësoi qëndresën e tyre. • Një qytetare ironizoi kryeministrin Edi Rama dhe zhvilloj fjalimin e saj para Kryeministrisë me pulë në dorë. • Ky veprim i saj ka ardhur pasi kryeministri u godit me vezë në protestën në New York. • Pas kësaj, qytetaria iu drejtua edhe Policisë së Shtetit, duke kërkuar arrestimin e kryeministrit. • Një protestues u ndal të zhvillimet që lidhen me Shërbimin Informativ të Shtetit, duke e cilësuar situatën si një skandal me përmasa ndërkombëtare. • Sipas protestuesit, disa vende anëtare të NATO-s kanë ndërprerë ndarjen e informacionit me Shqipërinë, duke e lidhur këtë me çështjen e Vlora Hysenit. • Ai tha se kjo nuk duhet parë si një çështje personale, por si një problem që prek funksionimin dhe sigurinë e shtetit. • Protesta e cila nisi si një reagim i drejtpërdrejtë ndaj situatës së ndodhur në Zvërnec, përfundoi në kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. • Me pankarta në duar dhe flamuj kuqezi, protestuesit kanë bërë thirrje për ndryshim. • Protesta ka bërë bashkë fëmijë, të moshuar, studentë, profesionistë, aktivistë dhe turistë. • Qytetarët kanë kërkuar plotësimin e pesë kërkesave të cilat përfshijnë dorëheqjen e panegociushme të kryeministrit Rama, krijimin e një qeverie teknike dhe ndryshime kushtetuese. • Tubimet janë shoqëruar me marshime nëpër rrugët kryesore të Tiranës, ndërsa qytetarët kanë ndaluar edhe pranë institucioneve të tjera, përfshirë Parlamentin, ku kanë përcjellë mesazhe ndaj deputetëve. • "Edi Rama, o tradhtar, me Shqipërinë mos bëj Pazar", "Rama, jep dorëheqjen", "Pa rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Shqipëria kërkon revolucion", "O Erion, o legen, prite Ramën se po vjen" dhe "Ju erdhi fundi", këto ishin disa nga thirrjet e tyre.

12 artikuj për këtë temë.

51 MINUTA ME PARE

Mbyllen fjalimet te Kryeministria, nis marshimi i protestuesve në rrugët e Tiranës



editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën



Pamje nga marshimi

TIRANA- Protestuesit kanë mbyllur fjalimet para Kryeministrit dhe kanë nisur marshimin në rrugët e Tiranës. Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrit ku bënë thirrje për ndryshim dhe kërkuan dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama.

"Edi Rama, jep dorëheqjen", "Ju erdhi fundi", "Rama në burg, Berisha në burg" dhe "Ndryshim sistemi" ishin disa prej sloganeve të përsëritura gjatë protestës./Dosja.al

56 MINUTA ME PARE

"Skandali i SHISH në Shqipëri është lajm ndërkombëtar"/ Protestuesi: Është institucioni i tretë më i rëndësishëm për mbajtjen e një shteti në këmbë



Protestuesi

TIRANA- Një protestues ka marrë fjalën në podium gjatë tubimit të zhvilluar ditën e 119-të, ku ka deklaruar se protesta vijon kundër korrupsionit dhe shitjes së Shqipërisë. Në fjalën e tij, ai u ndal te zhvillimet që lidhen me Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH), duke e cilësuar situatën si një skandal me përmasa ndërkombëtare.

Sipas protestuesit, disa vende anëtare të NATO-s kanë ndërprerë ndarjen e informacionit me Shqipërinë, duke e lidhur këtë me çështjen e Vlorë Hysenit. Ai tha se kjo nuk duhet parë si një çështje personale, por si një problem që prek funksionimin dhe sigurinë e shtetit. Njëkohësisht ai e cilësoi SHISH-in si një prej institucioneve kryesore për funksionimin e shtetit dhe deklaroi se fitorja më e madhe do të ishte rrëzimi i qeverisë.

"Fitorja më e madhe do të jetë dita që kjo qeveri mafioze të bjerë. Ndeshja që luhet këtu prej 119 ditëve kundër korrupsionit, tradhtisë dhe shitjes së Shqipërisë. Skandali i SHISH në Shqipëri është lajm ndërkombëtar...dhe në vecanti në shtetet anëtare të NATO-s ku 29 prej tyre kanë ndërprerë ndarjen e informacionit me shtetin shqiptar.. Pra ky shtet nuk ka marrëdhënie me vende të NATO-s sa i përket informacionit. Skandali i Vlorë Hysenit nuk është skandal rozë, por i rënies së shtetit. Skandali në SHISH për garancinë e institucioneve në Shqipëri, SHISH është institucioni i tretë më i rëndësishëm për mbajtjen e një shteti në këmbë", tha ai./Dosja.al

57 MINUTA ME PARE

"Kemi në krye një kriminel"/ I riu shpërthen në protestë: Diktatori që kemi ne në krye përndjek shqiptarët, po ndot gjuhën shqipe



Në vëmendje

POLITIKE 26 SHTATOR 2026, 20:44

"Ka kaç shumë për të thënë", Saimir Tahiri paralajmëron rikthimin: Do shihemi së shpejti

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 20:10

Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën Elvis Shkambit

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 14:13

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve

më të klikuarat

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

Aksioni i SPAK kundër grupit Rraja/ Shkon në 17 numri i të dyshuarve, Indrit Dokle i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve



SPAK operacion në Shkodër e Tiranë/ Goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

insights



Protestuesi

TIRANA- Protesta në Tiranë ka shënuar ditën e sotme 119-të ditë të revoltës qytetare kundër klasës politike. Gjatë tubimit përballë godinës së Kryeministrit, një i ri ka marrë fjalën e tij në podium ku ka akuzuar kryeministrin Edi Rama për përndjekje të shqiptarëve dhe për qëndrime të pamjaftueshme ndaj çështjeve të shqiptarëve jashtë kufijve.

Gjatë fjalës së tij ai përmendi Kosovën dhe Çamërinë, duke pretenduar se ka pasur plane për ndarjen e Kosovës. Protestuesi e akuzoi Ramën për lidhje me persona të botës së kimit dhe kritikoi gjuhën e përdorur nga ai në publik. Ai e mbylli fjalën e tij, duke kërkuar largimin e kryeministrit të vendit Edi Rama nga drejtimi i shtetit dhe tha se populli shqiptar nuk e mbështet më.

"Kemi në krye një kriminel, një diktator, një piktor. Diktatori që kemi ne në krye përndjek shqiptarët. Një shqiptar që ka përndjekur edhe shqiptar, dhe nuk ka ngritur njëherë zërin për shqiptarët jashtë kufijve, as për Çamërinë dhe as për Kosovën. Mos harrojmë se ka pasur një plan për ndarjen e Kosovës. Kemi një diktator që po ndot gjuhën shqipe. Besa e shqiptarit është traditë e shqiptarit. Rama ia ka dhënë besën mafiozëve. Uroj që gjithë komuniteti ndërkombëtar ta ketë parë se me cilin diktator kanë të bëjnë, sepse populli i tij nuk do më. Spiuni i tij MC Gonigal dergjet në burgjet e New York. Rama të largohet se po i zë diellin Shqipërisë", tha ai./**Dosja.al**

1 ORE ME PARE

"E ardhmja është te rinia"/ Protestuesi: Shqipëria i ka pasur djemtë e saj nëpër luftëra, ky vend ka shpresë dhe të ardhme



Protestuesi

TIRANA- Qytetarët janë mbledhur në shesh për të 119-tën ditë radhazi. Pas grumbullimit në sheshin Skënderbej, ata janë vendosur përballë godinës së Kryeministrit ku kanë mbajtur fjalimet e tyre në lidhje me protestën. Një protestues, gjatë fjalës së tij, u bëri thirrje qytetarëve të angazhohen për vendin dhe të mos e shohin protestën vetëm si një tubim.

Duke marrë shkas nga ndeshja e ditës së sotme mes Shqipërisë me Bjellorusisë ai ka kritikuar edhe mënyrën se si menaxhohet futboli shqiptar, duke pretenduar se përfaqësuesit i shërbejnë një federate që bën korrupsion. Gjatë fjalës së tij, duke iu drejtuar të rinjve dhe studentëve, i riu ngriti shqetësimin për mundësitë e punës dhe të ardhmen e tyre pas përfundimit të studimeve. Ai shtoi se shpresa e vendit është te rinia dhe vlerësoi pjesëmarrësit në protestë, pavarësisht numrit të tyre.

"Sa herë ne dalim në protestë dalim për atë flamur. Çdo shqiptar që ka shkuar në atë stadium ku luan kombëtarja duhet ta dijë se ato burra që ndjekin topin në fushë nuk janë ata Shqipëria, i shërbejnë një presidenti të një federate që bën korrupsion. Duhet të jemi këtu në shesh. Jo për të parë dhe bërë xhiro por për ti dalë zot këtij vendi, atdheut. Shqipëria e shqiptarëve vdekja është e tradhtarëve. Studentët në 5 tetor do fillojnë universitetin. A ka bij nënash që më datë 5 do hyjnë në shkollë dhe mendojnë se a do kenë një punë? Nuk i shikojnë lotët e nënave të tyre ku mendojnë se nuk kanë të ardhme në vendin e tyre? E ardhmja është te rinia. Dëgjo që flasin shumë për bashkim, shikoj një shpirt të pastër te gjithsecili këtu te ju. Nuk më intereson nëse sheshi është plot apo bosh. Edhe 2 sikur të jenë me shpirtin e pastër ky vend ka shpresë dhe të ardhme. Nëna Shqipëri i ka pasur djemtë e saj nëpër luftëra. Nëna Shqipëria lënaon se shqiptarët vuajnë në rruatë e kurvës

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë shpresë ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow.

1 ORE ME PARE

"Të gjitha SHIK-sat që janë mes nesh të shporren"/ Protestuesi: Duhet të jemi krah për krah që të rrëzojmë Edi Ramën



Protestuesi

TIRANA- Protesta qytetare në Tiranë ka shënuar ditën e saj 119-të të revoltës. Pas grumbullimit në sheshin Skënderbej, qytetarët kanë nisur marshimin drejt godinës së Kryeministrit ku kanë mbajtur fjalimet e tyre. Një protestues i cili është ngjitur në podium i ka bërë thirrje qytetarëve që të marrin pjesë në protestë, ndërsa ka akuzuar Vlorë Hysenin se ka shpërndarë informacione të rreme me synim përçarjen e protestës.

Ai u bëri thirrje personave që i cilësoi si pjesë të SHIK-ut të largohen nga protesta, duke thënë se tubimi nuk do të përçahet. Njëkohësisht, protestuesi u bëri thirrje qytetarëve që po e ndjekin tubimin nga shtëpia të dalin në shesh, duke akuzuar qeverinë për korrupsion dhe duke kërkuar rrëzimin e kryeministrit Edi Rama.

"Vlorë Hyseni kjo tradhtar e kombit ka shpërndarë informacione të rreme për të përçarë këtë protestë. Sot doja t'i bëjë thirrje të gjitha SHIK-save që janë mes nesh të shporren sepse këtë protestë nuk e përçanë dot. Të gjitha ta shqiptarë që kanë shpirt opozita dhe duan vendin e tyre ta shohin sa më mirë, sot është dita për të dalë në shesh. Të gjithë ta socialistë të ndershëm e ka për detyrë që sot jetë në shesh. Të gjithë ata që na ndjekin nga televizori, çfarë prisnin? Shpin po ua marrin, Shqipërinë po ua shesin... çohuni nga divani dhe ejani këtu të gjithë...Duhet të jeni këtu sa nuk është vonë. Duhet të jemi krah për krah për të luftuar qeverinë më të korruptuar, të rrëzojmë Edi Ramën", tha ai./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Rama u godit me vezë në protestën në New York/ Qytetarja ironizon kryeministrin, me pulë dorë para Kryeministrit: Hajdeni arrestojeni



TIRANA- Një qytetare ka ironizuar ditën e sotme kryeministrin e vendit Edi Rama dhe ka zhvilluar fjalimin e saj para Kryeministrit me pulë në dorë. Ky veprim i saj ka ardhur pasi kryeministri u godit me vezë në protestën në New York. Pas kësaj, qytetarja iu drejtua edhe Policisë së Shtetit, duke kërkuar arrestimin e kryeministrit.

Qytetarja: Një thirrje për Hasramën...Hajde mëru me pulat se me burrat nuk merresh. Edi Rama ka frikë pulat në Amerikë , a ka frikë pulat në Shqipëri. Policia hajdeni vejani prangat se nuk mundeni të arrestoni as Ramën dhe as Ballukun. Hajdeni arrestojeni./**Dosja.al**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.